

VENDIM
Nr. 81, datë 28.12.2015

NË EMËR TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:

Bashkim Dedja	kryetar i Gjykatës Kushtetuese			
Sokol Berberi	anëtar i	“	“	“
Vitore Tusha	anëtare e	“	“	“
Fatmir Hoxha	anëtar i	“	“	“
Gani Dizdari	anëtar i	“	“	“
Besnik Imeraj	anëtar i	“	“	“
Fatos Lulo	anëtar i	“	“	“
Vladimir Kristo	anëtar i	“	“	“

me sekretare Edmira Babaj, në datën 10.11.2015 mori në shqyrtim në seancë plenare, mbi bazë dokumentesh, çështjen nr. 67 Akti, që i përket:

KËRKUES: Elidon Fejzo

SUBJEKTE TË INTERESUARA: Ministria e Financave, Dega e Thesarit Vlorë, në mungesë, Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Vlorë, në mungesë.

OBJEKTI: Konstatimi i cenimit të së drejtës për një proces të rregullt ligjor si rrjedhojë e mosgjyqimit brenda një afati të arsyeshëm.

BAZA LIGJORE: Nenet 42/2, 131/f dhe 134/1/g të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; nenet 6 dhe 13 të Konventës Evropiane të të Drejtave të Njeriut (KENDNJ).

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoji relatorin e çështjes Vladimir Kristo, mori në shqyrtim pretendimet me shkrim të kërkuarit, që është shprehur për pranimin e kërkesës, prapësimet me shkrim të subjektit të interesuar, Ministrisë së Financave, që ka kërkuar rrëzimin e kërkesës, si dhe diskutoi çështjen në tërësi,

VËREN:

I

1. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Vlorë, me vendimin nr. 334, datë 29.11.2008, ka vendosur masën e sigurimit “arrest me burg” ndaj kërkuarit, pasi ka qenë i dyshuar për kryerjen e veprës penale “vrasje me dashje”, e mbetur në tentativë. Kjo masë në datën 11.12.2009 është zëvendësuar me “arrest në shtëpi”.

2. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Vlorë, me vendimin nr. 264, datë 23.6.2010, ka vendosur dënimin e kërkuarit me 3 vjet burgim për veprën penale “plagosje të lehtë me dashje”. Ky vendim është lënë në fuqi nga Gjykata e Apelit Vlorë.

3. Nga koha e arrestimit të kërkuarit deri në kohën kur vendimi për dënimin e tij ka marrë formë të prerë, kanë kaluar 3 vjet, 6 muaj dhe 19 ditë. Me pretendimin se ka kryer 6 muaj dhe 19 ditë më tepër se dënimi i caktuar, kërkuari i është drejtuar Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë me kërkesëpadi me objekt kompensim për burgim të padrejtë.

4. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Vlorë, me vendimin nr. 791, datë 2.4.2013, ka vendosur pranimin pjesërisht të kërkesës dhe detyrimin e palëve të paditura të shpërblejnë kërkuarin në masën 199.000 lekë si kompensim për burgim të padrejtë.

5. Kundër vendimit të lartpërmendur është bërë ankim nga palët ndërgjyqëse. Gjykata e Apelit Vlorë, me vendimin nr. 1236, datë 3.7.2014, ka vendosur dërgimin e çështjes për moskompetencë lëndore në Gjykatën Administrative të Apelit Tiranë. Nga dokumentet bashkëlidhur kërkesës

rezulton se Gjykata e Apelit Vlorë e ka nisur çështjen në Gjykatën Administrative të Apelit Tiranë në datë 16.9.2014. Ndërsa nga *website*-i i Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë vërehet se çështja në atë gjykatë është regjistruar në datën 16.10.2014. Ndërkohë nga momenti i regjistrimit të çështjes deri në kohën e paraqitjes së kërkesës në Gjykatën Kushtetuese rezulton se çështja nuk është gjykuar.

6. Me shkresën nr. 14/1 prot, të datës 28.7.2015, në përgjigje të kërkesës së dërguar nga kjo Gjykatë, Gjykata Administrative e Apelit Tiranë ka konfirmuar se çështja është regjistruar pranë kësaj gjykate në datën 16.10.2014 dhe se i kaluar për gjykim gjyqtarës B.H. Gjithashtu, nga shkresa e lartpërmendur konfirmohet se çështja në fjalë nuk është planifikuar akoma për gjykim për shkak të ngarkesës në Gjykatën Administrative të Apelit Tiranë.

II

7. **Kërkuesi** në kërkesën drejtuar kësaj Gjykate kërkon konstatimin e cenimit të së drejtës kushtetuese për një proces të rregullt ligjor, si pasojë e mosgjyimit të çështjes brenda një afati të arsyeshëm (neni 42/2 i Kushtetutës). Ai pretendon se edhe pse neni 48/2 i ligjit nr. 49/2012 “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative” (ligji 49/2012) për gjykimin e çështjes në apel parashikon një afat prej 30 ditësh nga data e ardhjes së ankimit, çështja ende nuk është gjykuar nga Gjykata Administrative e Apelit Tiranë.

8. **Subjekti i interesuar, Ministria e Financave**, ka prapësuar në mënyrë të përmbledhur se:

8.1 Në bazë të ligjit nr. 49/2012 Gjykata Administrative e Apelit Tiranë është gjykata kompetente për shqyrtimin e çështjes.

8.2 Kohëzgjatja e procesit gjyqësor nuk cenon të drejtën e kërkuesit për një proces të rregullt ligjor, pasi veprimi i paligjshëm i organit publik (heqja e lirisë) tashmë ka përfunduar dhe se vonesa në gjykim nuk ndikon në mundësitë e kërkuesit për të përfutur shumën e kompensimit.

8.3 Gjykimi i çështjes në një afat më të shkurtër do të kishte për pasojë shqyrtimin e saj nga një gjykatë së cilës i mungon kompetenca lëndore përkatëse dhe një vendim të pavlefshëm. Në këtë mënyrë dëmi që mund t'i shkaktohet kërkuesit nga gjykimi i çështjes në një afat më të gjatë, është më i vogël krahasuar me dëmin e shkaktuar nga dhënia e një vendimi absolutisht të pavlefshëm.

III

Vlerësimi i Gjykatës Kushtetuese

A. Për legjitimitimin e kërkuesit

9. Gjykata vlerëson se kërkuesi legjitimohet *ratione personae*, në kuptim të rregullimit kushtetues të neneve 131/f dhe 134/1/g të Kushtetutës, *ratione temporis*, pasi kërkesa është paraqitur brenda afatit të parashikuar nga neni 30/2 i ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000, “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, si dhe *ratione materiae*, pasi pretendimet e paraqitura në kërkesë *prima facie* përfshihen në juridiksionin e Gjykatës Kushtetuese.

B. Për shqyrtimin e çështjes brenda një afati të arsyeshëm

10. Gjykata në jurisprudencën e saj ka theksuar se në bazë të neneve 131/f dhe 134/1/g të Kushtetutës, individit legjitimohet për të vënë në lëvizje Gjykatën Kushtetuese, duke pretenduar cenimin e së drejtës për t'u gjykuar brenda një afati të arsyeshëm gjatë zhvillimit të procesit të gjyimit nga gjykata e zakonshme, për shkak se legjislationi nuk parashikon mjete të tjera juridike efektive për mbrojtjen e kësaj të drejte kushtetuese (*shih vendimin nr. 12, datë 5.3.2012 të Gjykatës Kushtetuese*).

11. Gjithashtu, Gjykata, lidhur me kërkesat për konstatimin e cenimit të së drejtës kushtetuese për një proces të rregullt ligjor, si pasojë e moszhvillimit të gjyimit të çështjes brenda një afati të arsyeshëm, ka theksuar se ky standard duhet të vlerësohet mbi bazën e kriterëve të përcaktuara në

jurisprudencën e GJEDNJ-së, sipas së cilës arsyeshmëria e kohëzgjatjes së procesit gjyqësor duhet të vlerësohet nën dritën e rrethanave të veçanta të çështjes, duke pasur parasysh sidomos kompleksitetin e çështjes, sjelljen e kërkuesit, sjelljen e autoriteteve, si dhe rrezikun që passjell për kërkuesin kjo tejzgjatje e afateve të gjykimit (*shih vendimin nr. 18, datë 19.7.2005; nr. 1, datë 19.1.2009; nr. 69, datë 17.11.2015 të Gjykatës Kushtetuese*). Për rrjedhojë, Gjykata çmon se për të vlerësuar nëse në rastin konkret jemi përpara cenimit të së drejtës për një proces të rregullt ligjor, duhet të analizohen elementet e sipërcituara.

i) Periudha që duhet marrë në konsideratë

12. Lidhur me *periudhën e kohës që duhet marrë në konsideratë*, Gjykata vëren se çështja në shqyrtim është regjistruar në Gjykatën Administrative të Apelit Tiranë në datën 16.10.2014 dhe se ajo nuk është planifikuar ende për gjykim, ndonëse neni 48/2 i ligjit nr. 49/2012 për gjykimin e çështjes në apel e detyron atë ta shqyrtojë çështjen brenda një afati prej 30 ditësh nga data e ardhjes së ankimit.

ii) Kompleksiteti i çështjes

13. Gjykata ka theksuar se për vlerësimin e kompleksitetit të procedimeve duhet të kenë rëndësi të gjitha aspektet e çështjes, përfshi objektin e çështjes, faktet e kundërshtuara dhe volumin e provave shkresore. Kompleksiteti i çështjes, në balancë me parimin e sigurimit të administrimit të përshtatshëm të drejtësisë, mund të justifikojë kohëzgjatje kohore të konsiderueshme (*shih vendimet nr. 14, datë 15.4.2010; nr. 9, datë 14.2.2014 të Gjykatës Kushtetuese*).

14. Në rastin në shqyrtim Gjykata konstaton se mosmarrëveshja objekt gjykimi është e natyrës administrative, gjykimi i të cilave parashikohet dhe rregullohet nga ligji nr. 49/2012, “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”. Objekti i saj lidhet me kompensimin për burgim të padrejtë. Nga shqyrtimi i dokumenteve të paraqitura, Gjykata vlerëson se çështja konkrete nuk paraqet rrethana të veçanta apo komplekse që mund të justifikojnë një vonesë në shqyrtimin e saj, ndaj vlerësimi i sjelljes së autoriteteve publike dhe kërkuesit është me rëndësi në këtë kontekst.

iii) Interesi dhe sjellja e kërkuesit

15. Vlerësimi i sjelljes dhe interesit të kërkuesit është një element tjetër përcaktues i kohëzgjatjes së arsyeshme të procedimeve. Nga aktet bashkëlidhur kërkesës Gjykata vëren se kërkuesi ka vepruar në përputhje me të drejtat procedurale, duke shfaqur interes të vazhdueshëm për gjykimin e çështjes brenda një afati sa më të përshtatshëm për të dhe nuk rezulton të jetë bërë shkak apo të ketë shkaktuar vonesa në këtë drejtim.

iv) Sjellja e autoriteteve

16. Gjykata ka theksuar se neni 42 i Kushtetutës, si dhe neni 6 i KEDNJ-së vendosin detyrimin për organizimin e sistemit ligjor të vendit në mënyrë të tillë që gjykatat të plotësojnë kërkesat e standardeve për një proces të rregull ligjor, përfshirë këtu edhe atë të gjykimit brenda afatit të arsyeshëm. Në këtë drejtim, gjykatat kanë për detyrë të sigurojnë që të gjitha subjektet që marrin pjesë në proces të sillen në mënyrë të tillë që të evitojnë çdo vonesë të panevojshme. Kjo detyrë e gjykatave gjen rregullimin e saj edhe në dispozitat procedurale civile, e konkretisht në nenin 4 të KPC-së, sipas të cilit “*gjykata kujdeset për zhvillimin e rregullt të procesit gjyqësor. Për këtë qëllim, në bazë të kompetencave që i jep ky Kod, vendos për afatet dhe urdhëron marrjen e masave të nevojshme*” dhe në nenin 171/a të KPC-së, sipas të cilit “*gjykata ushtron të gjitha të drejtat e përcaktuara në këtë Kod, që janë të nevojshme për zhvillimin sa më të mirë të procesit gjyqësor. Gjykata cakton seancat dhe afatet brenda të cilave palët dhe personat e tjerë të thirrur prej saj duhet të kryejnë aktet procedurale dhe veprimet e tjera të kërkuara prej saj*” (*shih vendimin nr. 12, datë 5.3.2012 të Gjykatës Kushtetuese*).

17. Edhe për gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative, Gjykata ka vlerësuar tashmë në jurisprudencën e saj se neni 3 i ligjit nr. 49/2012 të lartpërmendur, ndër parimet e gjykimit administrativ, ka përcaktuar sigurimin e një procesi të rregullt gjyqësor brenda afateve të shpejta dhe të arsyeshme. Ky ka qenë edhe qëllimi i ligjvënësit në krijimin e këtyre gjykatave. Kështu, në relacionin bashkëlidhur projektligjit nr. 49/2012 thuhet se ligji synon thjeshtimin e procedurave me

objekt zgjidhjen e mosmarrëveshjeve administrative dhe se qëllimi i krijimit të Gjykatës Administrative është garantimi i mbrojtjes efektive të të drejtave subjektive dhe interesave të ligjshme të personave nëpërmjet një procesi të rregullt gjyqësor dhe brenda afateve të shpejta e të arsyeshme. Gjithashtu, në relacionin e projektligjit të lartpërmendur lexohet se afatet e përcaktuara në ligj për gjykimin e çështjeve duhet të zbatohen nga gjykatat administrative për shqyrtimin e çështjeve. Për më tepër, ligji nr. 49/2012 ka parashikuar afate konkrete si për gjykimin në shkallë të parë (neni 25 për veprimet përgatitore dhe neni 27 për caktimin e seancës gjyqësore), për gjykimin në apel (neni 48/2 për shqyrtimin e çështjes nga gjykata e apelit), si dhe në Gjykatë të Lartë (neni 60/2 në shqyrtim) *(shih paragrafin nr. 24 të vendimit nr. 69, datë 17.11.2015 të Gjykatës Kushtetuese)*.

z të Apelit, në shkresën nr. 14/1 prot, të datës 28.7.2015, dërguar kësaj Gjykate, se shkak për vonesën në planifikimin e gjykimit është ngarkesa e madhe e çështjeve në gjykatë, nuk është i bazuar. Gjykata tashmë ka vlerësuar se ngarkesa e gjykatave nuk është argument kushtetues që mund të justifikojë mosgjykimin e tyre brenda afateve të përcaktuara nga ligjvënësi. Hyrja në fuqi e një ligji kushtëzon hyrjen në fuqi të normave të prodhuara prej tij, apo e thënë ndryshe, zbatueshmërinë e tyre nga ana e të gjitha organeve, përveç rasteve kur ligji parashikon ndryshe. Në të kundërt është detyrë e ligjvënësit të marrë masat dhe të gjejë mjetet e duhura për ndryshimin e gjendjes faktike, me qëllim që ligjet të zbatohen dhe gjykatat e të gjitha niveleve të funksionojnë normalisht *(shih paragrafin nr. 27 të vendimit nr. 69, datë 17.11.2015 të Gjykatës Kushtetuese)*.

21. Për këto arsye, Gjykata çmon se në çështjen në shqyrtim është cenuar e drejta e kërkuarit për një proces të rregullt ligjor për shkak të mosgjykimin të çështjes në Gjykatën Administrative të Apelit Tiranë brenda një afati të arsyeshëm. Për rrjedhojë, Gjykata arrin në përfundimin se pretendimi i kërkuarit është i bazuar dhe duhet pranuar.

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, në mbështetje të neneve 131, shkronja “f”, dhe 134, pika 1, shkronja “g”, të Kushtetutës, si dhe të neneve 72 e vijues të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000, “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, me shumicë votash,

VENDOSI:

- Pranimin e kërkesës.
- Konstatimin e cenimit të së drejtës për një proces të rregullt ligjor, si rezultat i mosgjykimin të çështjes në Gjykatën Administrative të Apelit Tiranë brenda një afati të arsyeshëm.

Ky vendim është përfundimtar, i formës së prerë dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

Anëtarë pro: Bashkim Dedja (kryetar), Sokol Berberi , Besnik Imeraj, Gani Dizdari, Fatmir Hoxha, Vladimir Kristo, Fatos Lulo

Anëtarë kundër: Vitore Tusha